

STATUT I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

AQUATECH SHPK

Ne Tirane, sot me date 20 Maj 2023 u mblodh Asambleja e Ortakeve te Shoqerise me prezencen e Ortakeve te saj z.Rubin Kodra, shtetas shoqiptar, i biri i Ymerit dhe Eves, lindur ne Tirane, me 27 Tetor 1982, banues ne Tirane, ne adresen: Bulevardi Bajram Curri, Pallatet Agimi, Shkalla 18, Ap. 12, madhor me zotesi juridike per te vepruar, identifikuar sipas ligjit nepermjet dokumentit te identifikimit me nr personal I21027050V, dhe z.Elton Dalipaj, shtetas shoqiptar, i biri i Enverit dhe Shkendijes, lindur ne Tirane, me 16 Dhjetor 1978, banues ne Tirane, ne adresen: Rruga Sami Frasheri, Pallati 20, Shkalla 2, Ap 23, madhor me zotesi juridike per te vepruar, identifikuar sipas ligjit nepermjet dokumentit te identifikimit me nr personal H81216097D te cilet me cilesine e "ortakeve themelues" redaktuan kete kete STATUT, nepermjet te cilit deklarojne se me vullnet te lire te plote e te sinqerte, dhe inisiativen e lire private, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin nr 9901 date 14.04.2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", i ndryshuar me ligjin nr 129/2014 date 01.10.2014, ne ligjin nr 9723 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Biznesit", i ndryshuar me ligjin nr 131/2015 date 26.11.2015, ne legjislacionin Doganor, Fiskal e Tatimor, krijon shoqerine tregtare, me pergjegjesi te kufizuar "**AQUATECH**" shpk.

KREUI

Neni 1 Krijimi

1.1 Shoqeria **AQUATECH shpk**, eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur "Shoqeria").

Neni 2 Personaliteti juridik

2.1 Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi te jetë regjistruar në Qendren Kombetare te Biznesit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me legjislacionin Shqiptar ne fuqi.



2.2 Shoqeria, pasi te ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

2.3 Shoqeria "**AQUATECH**" shpk., eshte nje e tille, kapitali i së cilës ndahet në pjese dhe që themelohet nga ortaket që përballon humbje vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tij në kapitalin themeltar.

Neni 3 Selia

3.1 Shoqeria e ka seline ne Tirane ne Adresen: Bulevardi Bajram Curri, Pallatet Agimi, Shkalla 18, Ap. 12; Njësia Administrative Nr. 5; Njësia Bashkiake Nr. 5; Tiranë

3.2 Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojte filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetëm me vendim te Ortakeve te Shoqerise.



Neni 4
Kohezgjatja

4.1 Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit.

Neni 5
Objekti i veprimtarise

Objekti i veprimtarise se Shoqerise "**AQUATECH**" shpk. perfshin:

5.1 Aktivitet ne projektim, instalim, supervizim,mirmbajtje testim, kolaudim te sistemeve te ngrohjes, klimatizimit, ajrimit, zjarreflkese,hidraulike, hidrosanitare, kamera sigurie, material elektrike,hidraulike, materiale dhe punime ndertimore te ndryshme,ujesjelles -kanalizime, pajisje hotelerie, elektroshtepiake dhe çdo lloj teknologjie.dhe mirembajtjen e tyre.

5. Ushtrimi i cdo lloj operacioni dhe transaksioni ne lidhje me importimin, eksportimin, tregetin, shitjen dhe shperndarjen e pajisjeve dhe materialeve te ndryshme te nevojshme ne fushen e ndertimit, te sherbimeve elektro – mekanike, ne natyren e lendeve te para, produkteve te gatshme apo gjysem te gatshme, ushqimore, industrial si dhe çdo aktivitet tjeter brenda kuadrit ligjor ne fuqi.

5.3 Tregetim, Import-Eksport me pakice te artikujve te ndryshem

KREU II
KAPITALI

Neni 6
Kapitali themeltar

6.1 Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100 000 (njeqinde mije) lekë, i ndare në 2 (dy) pjesë , vlere nominale e të cilit eshte 50 000 lekë.

6.2 Kapitali i mesiperme eshte nënshkruar dhe do te shlyet tërësisht ne te holla nga ortaket e shoqerise **AQUATECH shpk**, nepermjet transfertes bankare, kuota me vlere te pergjithshme 100 000 lekë, qe perbejne 100 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

6.3 Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlere të tregtueshme dhe as me kontribute në shërbime.



6.4 Ortaket pergjigjen per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tyre ne kapitalin themeltar te shoqerise;

Neni 7
Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

7.1 Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit te nje Audituesi Ligjor per keto kontribute ne natyre sipas kërkesës së Ortakeve te shoqerise.

7.2 Zvogëlimi i kapitalit realizohet me vendim te Ortakeve në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e Statutit. Projekti i zvogëlimit të kapitalit u komunikohet Audituesve Ligjore, në rast se ka të tillë, të paktën 45 ditë përpara datës së mbledhjes së Asamblese se Ortakeve te Shoqerise të thirrur për të marrë vendim rreth këtij projekti.

7.3 Zvogëlimi i kapitalit themeltar në një vlere më të vogël se ajo e përcaktuar në nenin 6 te



ketij statuti, e bën të detyrueshme marrjen e një vendimi prej shoqërisë për zmadhimin e kapitalit themeltar të paktën deri në vlerën minimale. Në të kundërt shoqëria duhet të shndërrohet në një formë tjetër. Në rast moszbatimi të kërkesave të këtij paragrafi, çdo personi interesuar mund të kërkojë në rrugë gjyqësore prishjen e shoqërisë. Kjo prishje nuk mund të shpallet, në qoftë se rregullimi është bërë në ditën kur gjykata mblidhet për të marrë vendim.

Neni 8
Transferimi i kapitalit

8.1 Pjesët e kapitalit themeltar mund tu transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri, vetëm me miratimin e Ortakeve të Shoqërisë.

8.2 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie. Ato janë të transferueshme edhe në rast ndarjeje pasurore mes bashkëshortëve. Gjithashtu janë të transferueshme ndërmjet bashkëshortëve, si dhe ndërmjet paraardhësve dhe pasardhësve nepermjet akteve ligjore.

KREU II
ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 9
Organi Vendimmarres

9.1 Asambleja e Ortakeve të Shoqërisë është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë.

9.2 Asambleja e Ortakeve të Shoqërisë është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statudit sipas modaliteteve të percaktuara në ligj.

9.3 Asambleja e Ortakeve të Shoqërisë brenda një afati prej gjashtë muajsh, duke filluar nga data e mbylljes së vitit financiar, miraton raportin e administrimit, inventarin, bilancin dhe llogaritë vjetore, të hartuara nga administratorët,

9.4 Asambleja e Ortakeve të Shoqërisë mund të përfaqësohet edhe nga një tjetër person, nepermjet prokures.

Neni 10
Ndryshimet e Statutit

10.1 Ndryshimet e statudit vendosen nga Asambleja e Ortakeve të Shoqërisë.

10.2 Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasyruar ndryshimet në skeden e shoqërisë.

Neni 11
Administrimi

11.1 Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim të Asamblese së Ortakeve të Shoqërisë.

11.2 Ortaket e Shoqërisë vendosin për sistemin e administrimit, dhe në rastin e një organi administrativ me shumë administratore, percakton numrin e tyre dhe kompetencat.

11.3 Administratori/ret, mund të jenë ose jo ortake.

11.4 Administratori/ret mund të shkarkohet në çdo kohë.

11.5 Shoqëria do të funksionojë me nivel një Administratori.

11.6 Administrator i shoqërisë është:

11.6 a, z. Rubin Kodra, shtetas shoqiptar, i biri i Ymerit dhe Eves, lindur në Tiranë, më 27 Tetor 1982, banues në Tiranë, në adresën: Bulevardi Bajram Curri, Pallatet Agimi, Shkalla 18, Ap. 12, i identifikuar sipas ligjit nepermjet dokumentit të identifikimit me nr personal I21027050V.

11.7 Administratori i shoqërisë do të ushtroje kompetencat e tij në këto detyra për një periudhë s (pese) vjecare.



Neni 12
Kompetencat

12.1 Shoqëria administrohet nga nje Administrator. Administratori ka të drejte të kryejne të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm.

12.2 Administratori përfaqësonë Shoqërinë përpara të gjithë personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve.

12.3 Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht Ortakeve te Shoqerise.

12.4 Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

12.5 Administratori ka gjithashtu të drejte të nënshkruaje kontrata të ndryshme në emër e për llogari te Shoqërisë, përfshi këtu kontratat e qirasë, shitjes, blerjes a hipotekimit të pasurive të paluajtshme, operacione financiare, të nënshkruajne aktet e themelimit të shoqërive të tjera ku Shoqëria është ortak, të nënshkruajne e hartojne çdo dokument e të kryejne në emër të Shoqërisë çdo veprim përballë të gjitha Bankave shqiptare apo te huaja në lidhje me çeljen apo mbylljen e llogarive rrjedhëse te Shoqërisë, nënshkrimin e kontratave te ndryshme bankare për financimin e Shoqërisë si dhe te kryeje veprime tërheqje e derdhje shumash nga këto llogari pa limit.

12.6 Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

12.7 Klauzolat e ketij Akt Themelimi që kufizojnë kompetencat e administratoreve, të cilat rrjedhin nga ky nen, duhet të respektohen nga të tretët.

12.8 Administratori ose Ortaku që nuk janë persona juridikë nuk u lejohet të kontraktojnë në çfarëdolloj forme qoftë, të marrin hua te shoqëria, të japin pëlqimin në emër të saj, për paradhënie si dhe të bëhen dorëzënës apo të garantojnë në emër të saj angazhimet ndaj të tretëve. Në rast të kundërt kontrata është e pavlefshme.

Neni 13
Pergjegjesite


13.1 Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

13.2 Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga Asamblea e Ortakeve te Shoqerise që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit, për të përballuar në mënyrë individuale pasojat përkatëse.

13.3 Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortaku ka të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit qe ka bere marrevshjen.

13.4 Ortaket kane të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme.

13.5 Ortaku që nuk është administrator, ka të drejtë në çdo kohë të informohet personalisht për veprimtarinë e shoqërisë dhe të njihet me llogaritë dhe dokumentet e shoqërisë.



Neni 14
Viti Financiar

14.1 Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor.

14.2 Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne QKB dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 15
Pasqyrat Financiare te Shoqerise dhe Dividentet

15.1 Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Asamblese se Ortakeve te Shoqerise, miraton Pasqyrat Financiare te paraqitura nga Administratoret.

15.2 Mbledhja e Asamblese se Ortakeve te Shoqerise vendos rreth shperndarjes se dividentit, pasi te jene zbritur humbjet e mbartura te viteve financiare, siç edhe parashikohet nga ligji.

Neni 16
Audituesi Ligjor

16.1 Audituesi Ligjor ka per detyre qe te kontrolloje te gjithe dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko tregtare te shoqerise, ate gjithëvjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ana e Ortakeve te Shoqerise.

16.2 Ne perfundim te kontrollit Audituesi Ligjor pergatit raportin me shkrim opinionin per miratimin e Pasqyrave Financiare vjetore si dhe per ate per kontrollet periodike te ushtruara, te cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe Administrimit dhe Drejtimit te Shoqerise per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e te drejtes vendimore qe ka.

Neni 17
Miratimi i Pasqyrave Financiare vjetore

17.1 Pasqyrat Financiare Vjetore, miratohen mbi bazen e vendimit me shkrim nga Asambleja e Ortakeve te Shoqerise, te cilet jo vetem qe dokumentojne miratimin e tyre por vendos ne lidhje me disponibilitetin e fondeve ligjore sipas nevojave te zhvillimit te metejshem te shoqerise dhe garantimin e veprimtarise se rregullt te saj, duke pasur parasysh fondin e akumulimit, krijimin e fondit te vecante per Rezervat Ligjore ne zbatim te legjislacionit ne fuqi.

Neni 18
Dividentet

18.1 Te ardhurat neto (Dividenti) qe mbeten pas vecimit te fondeve ligjore (Rezervave Ligjore ose Rezervave te tjera) te mesiperme dhe te atyre per shlyerjen e cdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj te treteve, i mbesin dhe i kalojne ne pronesi, Ortakeve te Shoqerise.

18.2 Te ardhurat neto mund te shperndahen sipas Vendimit te Asamblese se Ortakeve ne formen e Dividentit pas pageses se Tatimit mbi Dividentin sipas normave ne fuqi.

18.3 Te ardhurat neto mund te mbahen per investime sipas Vendimit te Asamblese se Ortakeve sipas legjislacionit ne fuqi.

Neni 19
Shperndarje, Likuidimi ose Prishja e Shoqerise



19.1 Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe dhe per cfaredo shkak, edhe para plotesimit të afatit per të cilen eshte krijuar sic mund të jene :

19.2.a Humbja e kapitalit ose pamundesia e vazhdimit të metejshem të veprimtarise se saj.

19.2.b Ne nje nga menytrat e parashikuara nga ligji " Per Falimentimin e Shoqerive Tregtare"

19.2.c Kur plotesohet afati i caktuar per ushtrimin e veprimtarise tregtare.

19.3 Ne kete rast Ortaket e Shoqerise marrin vendim me shkrim ne të cilin parashikon menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1(nje) apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese "Shoqeri ne likuidim e siper"

Neni 20

Bashkimi dhe ndarja

20.1 Shoqëria, me anë të bashkimit, mund t'i kalojë trashëgiminë e saj një shoqërie ekzistuese ose një shoqërie të re që ajo themelon.

20.2 Shoqëria gjithashtu me anë të ndarjes mund t'i kalojë trashëgiminë e saj disa shoqërive të tjera ekzistuese ose disa shoqërive të reja.

20.3 Ortaket e Shoqërise, që bëjnë kalimin e trashëgimisë së saj në kuadrin e operacioneve të përmendura me lart përfiton pjesë të kapitalit themeltar nga shoqëria ose shoqëritë përfituese dhe sipas rastit një kompensim me para, vlera e të cilit nuk mund të kalojë 10% të vlerës nominale të pjesëve të kapitalit themeltar të dhëna.

20.4 Operacionet e përmendura me lart mund të realizohen ndërmjet shoqërive të formave të ndryshme.

20.5 Bashkimi ose ndarja sjell prishjen pa likuidim të shoqërise që zhduket, dhe kalimin e plotë të trashëgimisë së saj të shoqëritë përfituese, në gjendjen në të cilën ndodhet kjo trashëgimi në datën e realizimit përfundimtar të operacionit.

20.6 Bashkimi ose ndarja sjell njëkohësisht për ortakët e shoqërive që zhduken marrjen e cilësisë së ortakëve të shoqërive përfituese sipas kushteve të përcaktuara në kontratën e bashkimit ose ndarjes.

Neni 21

Likuidatorët

21.1 Ne rastet kur Asambleja e Ortakeve të Shoqerise vendos për kalimin në Likuidim të shoqerise në kushtet e likuidimit të zakonshëm, ajo njëkohësisht emeron një Likuidator për të ndjekur procesin e likuidimit të shoqerise.

21.2 Afati i emerimit të Likuidatorit, publikohet sipas kushteve që parashikon ligji përkatës duke specifikuar dhe dokumentat që duhen depozituar në Aneksin e Regjistrimit Tregtar.

21.3 Likuidatori është i detyruar që të jetë i vemendshëm dhe korrekt, si për realizimin e të drejtave për subjektet ndaj të cileve shoqëria është kreditore dhe për ekzekutimin e detyrimeve debive që shoqëria ka ndaj shtetit, shtetasve të vecantë apo personave fizikë apo juridikë vendas apo të huaj.

Neni 22

Baza Ligjore

22.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këto statut dhe dispozitat e legjisllacionit shqiptar.


22.2 Për sa nuk parashikohet në këto statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 23
Mosmarveshjet

23.1 Per mosmarveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij Statuti, si dhe per çdo mosmarveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 24
Dispozita perfundimtare

24.1 Ky statut u redaktua ne 4 ekzemplare me permbajtje dhe vlera te njejta juridike, ne gjuhen shqipe, dhe pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaket themelues te shoqerise tregtare **AQUATECH shpk.**, nenshkruset ne të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen e tij orgjinale, autenticiteti i të cileve vertetohet nga dokumenti i identifikimit ketu bashkengjitur.



ORTAKET

